# BASHKIA KRUJË

NJOFTIM PËR DHËNIE ME QIRA

1. Autoriteti Qiradhënës:

Emri Bashkia Kruje
Adresa Qender Kruje
Tel/Fax 051122170
E-mail info@kruja.gov.al
Faqja e Internet:www.kruja.gov.al

2. Të dhënat për sipërfaqen: Siperfaqe e fondit pyjor/ kullosor prej 10.3 ha, në ngastrën nr. 199, 200, 202/5 , 20, 203 , 22, 227, pjesë e Ekonomisë Pyjore Kullosore ‘’ Kraste-Kruje ‘’, në administrim/pronësi të Bashkisë Krujë”

3.Qëllimi i dhënies me qira:‘’Vendosje stacionesh, bazamentesh per panele fotovoltaike me qellim prodhimin e energjise’’.

4.Afati i dhënies me qira: është 10 (dhjetë) vite, duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës.

5.Vlera dysheme për detyrimin e qirasë: është 1’812’800(njemilion e teteqind e dymbedhjete mije e teteqind) lekë në vit në vit, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave me Nr. 559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/ përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”, referuar afatit kohor të dhënies në përdorim dhe llojit të veprimtarisë që do të ushtrohet.

6.Vlerësimi i konkurrentëve do të bëhet sipas këtyre pikave:

| Nr | Lloji i kriterit | Pesha e matur ne pike e kriterit vleresues (e shprehur ne pike) |
|---|---|---|
| 1 | Projekti teknik i veprimtarisë që do të ushtrohet, i cili përmban hartën topografike me koordinatat e sipërfaqes objekt përdorimi në variantin PDF dhe në forKrujë elektronik në shkallë 1:10000 ku të jenë evidentuar elementet kryesore, si: kufijtë natyrorë, relievi, objektet aktuale, si dhe çdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar, hartuar konform kërkesave të projektit | 20 pike |
| 2 | Planbiznesi dhe investimet që do të bëhen | 15 pike |
| 3 | Planin e rehabilitimit të sipërfaqes | 25 pikë |
| 4 | Nivelin e punësimit në veprimtari | 5 pikë |
| 5 | Masën e qirasë për ha/vit | 35 pikë |

7. Dokumentacioni që duhet të plotësohet nga konkurrentët për konkurrim është:
I. Kushtet e pjesëmarrjes në konkurrim janë:
a)garanci financiare të mjaftueshme për përballimin e investimeve të parashikuara në planbiznes.
b) të ketë të kontraktuar një specialist të fushës, ku në CV-në profesionale të tregohet përvoja në fushën e veprimtarisë.
c)Vërtetim nga organet përkatëse shtetërore se subjekti nuk ka procese gjyqësore në ngarkim, hetim në proces.
d)Vertetim qe nuk ka detyrime tatimore (Te leshuar nga platofrma elektronike E-albania).
e)Vertetim per shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore perfshire edhe detyrimet vendore per vitin 2023 te leshuar nga ana e njesise vendore ku operatori ekonomik ka seline sipas QKB, ne rast se jane plotesuar afatet e Krujëurimit te detyrimeve vendore per periudhen e mesiperme ne perputhje me kerkesat e ligjit nr 9632 date 30.10.2006 ‘‘ Për sistemin e taksave vendore’’, i ndryshuar.

II. Dokumentacioni i nevojshëm:
a. Kërkesën e subjektit për marrjen me qira të pasurisë shtetërore, së bashku me të dhënat për gjeneralitetet e tyre;
b. Ekstraktin e regjistrimit në QKR për objektin e veprimtarisë;
c. Projektin teknik të hartuar nga specialistë të licencuar ku janë trajtuar të gjitha elementet e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë së kërkuar;
d. Planbiznesin dhe investimet që do të bëhen;
e. Të dhëna për kapacitet teknike, stafin, makineritë dhe pajisjet që zotëron;
f. Planin e rehabilitimit të sipërfaqes dhe kthimin e saj në gjendjen e mëparshme;
g. Nivelin e punësimit në veprimtari;
h. Çmimin e qirasë së ofruar për ha/vit;

i. Adresën e subjektit, telefon, email dhe faks;
Të gjitha dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

9.Dokumentacioni duhet të paraqitet në zarf të mbyllur, të nënshkruar nga konkurruesi me mbishkrimin "Ofertë për dhënie me qira", në zyrën e protokollit të Bashkisë Krujë, dhe më pas i dorëzohet komisionit të posaçëm për vlerësimin e dokumentacionit, në orën e hapjes së proçedurës së konkurrimit.
Ofertat dorëzohen nga konkurrenti/ët e interesuar, fizikisht me postë ose dorazi në vendin e përcaktuar për zhvillimin e konkurrimit.

10.Data e zhvillimit të konkurrimit: 22.08.2024 , ora 12:00, në ambientet e Bashkisë Krujë, Kati I III-te Zyra e Drejtorise se Menaxhimit te Tokes dhe Pronave

11.Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje: datë 22.08.2024 , ora 12:00.

## MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

NJOFTIM PËR FILLIMIN E PROCESIT TË QIRADHËNIES.

Në zbatim të Vendimit Nr. 373, datë 20.6.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës TIP për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit", i ndryshuar, kreu IV "Procedurat që ndiqen për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit", pika 4.1, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural njofton fillimin e procesit për dhënien me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për pasuritë me Nr. 147; Nr. 148; Nr. 149; Nr. 150; Nr. 151; Nr. 153; Nr. 155; Nr. 156; Nr. 157; Nr. 158; Nr. 161; Nr. 162; Nr. 163/2; Nr. 170; Nr. 171; Nr. 172; Nr. 173; Nr. 174; Nr. 176; Nr. 177; Nr. 178; Nr. 179; Nr. 181; Nr. 182; Nr. 183; Nr. 184; Nr. 185; Nr. 190; Nr. 191; Nr. 192; Nr. 193; Nr. 194; Nr. 195; Nr. 196; Nr. 199; Nr. 200; Nr. 201; Nr. 202; Nr. 203; Nr. 204; Nr. 205; Nr. 206; Nr. 207; Nr. 208; Nr. 209; Nr. 210; Nr. 211; Nr. 212; Nr. 213; Nr. 214; Nr. 215; Nr. 216; Nr. 217; Nr. 218 dhe Nr. 219, Zona Kadastrale Nr. 3359, me vendndodhje në fshatin Sheqeras, Njësia Administrative Vreshtas, Bashkia Maliq, qarku Korçë.